

Mesazh nga z-nja Odri Azulle

drejtoreshë e përgjithshme e UNESCO me rastin e Ditës Botërore të Poezisë

21 mars viti 2022

E rregulluar me fjalë, e ngjyrosur me piktura, e theksuar me metrikë reale, fuqia e poezisë është e pakrahasueshme. Si formë intime shprehjeje që hap dyert, poezia ka pasuruar dialogun që katalizon përparimin njerëzor dhe është i nevojshëm më shumë se kurrë në këto kohë të turbullta.

Kjo është veçanërisht e vërtetë për popujt indigjenë, gjuhët dhe kulturat e të cilëve kërcënohen gjithnjë e më shumë, veçanërisht nga zhvillimi industrial, ndryshimet klimatike dhe konfliktet. Për këto komunitete, poezia luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e diversitetit gjuhësor dhe kulturor dhe ruajtjen e kujtimeve.

Poetja XhJoy Harxho, një amtare amerikane Moskovite, e cila është laureate amerikane, e bën të qartë këtë. Poezia e saj "Zemër e thyer" përshkruan rikthimin e saj në Okfuski, Oklahoma, nga ku paraardhësit e saj u dëbuan në bazë të Aktit të Risistemimit të Vendasve Amerikanë të vitit 1830. Ajo fuqishëm thekson:

"Poezia nuk mund të detyrohet,

As të robërohet ...

historia do të të gjejë gjithmonë

dhe do t'ju mbështjell

me mijëra duart e saj."

Sot, në Ditën Botërore të Poezisë, UNESCO fokusohet në poezinë vendase për të kremtuar rolin e saj unik dhe të fuqishëm në luftën kundër marginalizimit dhe padrejtësisë, si dhe në bashkimin e kulturave në frymë solidariteti.

Kjo ditë përputhet me shënimin e fillimit të dekadës Ndërkombëtare të gjuhëve autoktone nga ana e shteteve të bashkuara, ndërsa nën Udhëheqjen e UNESCO me qëllim që të vërtetohet angazhimi i shoqërisë ndërkombëtare në mbështetjen e popujve indigjenë në mbrojtjen e kulturës, njohurive dhe të drejtave të tyre.

Si pjesë e përpjekjeve tona për të mbrojtur traditat, në listen Pëfaqësuese të trashëgimisë jo materiale të njerëzimit UNESCO ka gdhendur disa forma poetike siç janë: këndimi i Hudhud e Filipineve, tradita goroje Mapojo nga Venecuela, këndimi i Eshuva, Harakmbut- lutjet e Peru dhe tradita gojore e Kuger nga Uganda.

Çdo formë e poezisë është unike, por secila pasqyron natyrën universale të përvojave njerëzore –
kërkimit tëbë për kreativitet që kalon të gjithë kufijtë. Kjo është fuqia e poezisë